



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 88, datë 01.06.2018

PËR

REFUZIMIN E MIRATIMIT TË KANDIDATURËS SË PROPOZUAR NGA
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ANËTARËVE TË BSHS-SË.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të nenit 43, pika 2, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, të nenit 21, pika 5, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të Rregullores nr. 137, datë 21.12.2015 “Mbi procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administratorit/anëtarit të bordit të drejtorëve të shoqërisë së sigurimit”, me propozim të Zyrës së Licencimit, pranë Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

KONSTATOI SE:

Byroja Shqiptare e Sigurimit me shkresën nr. 2710, datë 18.05.2018, ka depozituar vendimin nr. 10, datë 03.05.2018 të Asamblesë së Anëtarëve të saj, për miratimin e emërimit të Drejtorit Ekzekutiv të BSHS-së, z. Kevin Lleshi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe informacionit të renditur në relacion paraqitet problematike fakti që kandidati është subjekt i masave administrative nga Bordi i Autoritetit, me Vendimin nr. 86, datë 07.05.2018, për shkak të moszbatimit nga Byroja Shqiptare e Sigurimit të vendimeve të Autoritetit nr. 217 dhe 218, datë 28.12.2017.

Gjithashtu, gjatë veprimtarisë së BSHS-së, janë evidentuar problematikat si më poshtë:

- Në përgjigje të korrespondencave të vazhdueshme të kryera nga zyra BSHS, për buxhetin e BSHS-së të vitit 2018, (me shkresat e AMF-së nr. 618 prot., datë 14.02.2018 dhe 618/3,

datë 28/02/2018), për depozitimin e buxhetit të rishikuar duke përfshirë dhe shpenzimet mbi shoqërinë audituese ndërkombëtare, kërkesë në zbatim të vendimit të Bordit të AMF-së, nr. 218, datë 28.12.2017, BSHS nuk ka depozituar ende për miratim pranë AMF-së buxhetin e vitit 2018;

- Në lidhje me rastet e ankimimeve të depozituara në Autoritet, mbi praktikën e dëmeve, të cilat rezultojnë të miratuara por të papaguara, kërkesë në zbatim të vendimit të Bordit të Autoritetit nr. 217, datë 28.12.2017, për të cilat është kërkuar informacion, BSHS nuk ka depozituar informacionin e kërkuar në AMF;
- Gjithashtu, nuk ka zbatuar kërkesat e Rregullores nr. 2, datë 28.01.2010, e ndryshuar, pasi nuk ka depozituar informacion mbi asgjesimin e policave të pakonsumuara të viteve pararendëse, afati i asgjesimit të të cilave ishte 31.01.2018.

Po kështu, konstatohet moszbatim i vendimeve të Autoritetit, si dhe neglizhencë në mbarëvajtjen dhe funksionimin e Byrosë Shqiptare të Sigurimit, në funksion të përmbushjes së detyrave funksionale të Byrosë në përgjithësi, si dhe përmbushjes së detyrimeve që lidhen me Fondin e Kompensimit në veçanti.

Përsa më sipër, në bazë të pikës 5/a, të nenit 21 të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Refuzimin e kërkesës së Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve të BSHS-së, për miratimin e z. Kevin Lleshi, si Drejtor Ekzekutiv i Byrosë Shqiptare të Sigurimit.
2. Byroja Shqiptare e Sigurimit, brenda 7 ditëve nga data e marrjes së këtij vendimi, të procedojë me përzgjedhjen e kandidaturës për funksionin e Drejtorit Ekzekutiv të Byrosë Shqiptare të Sigurimit.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI